



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere**  
**Mbledhja nr.17**  
**Prishtinë, më 25.05.2022, në orën 10:00**  
**Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla C-203**

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Armend Muja, kryetar, Mërgim Lushtaku, nënkryetar, Verica Ceraniq, nënkryetare, Enver Haliti, Jeta Statovci, Visar Korenica, Eman Rrahmani, Avdullah Hoti, Ferat Shala, Pal Lekaj dhe Duda Balje, anëtarë të Komisionit.

**Të ftuar:** Valon Kryeziu, zv. drejtor, AIP, Shpend Reçica, ZKF, AIP dhe Bekim Haxhiu, deputet.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Egzona Tërdevci, asistente Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Ardit Mehana, praktikant, Violeta Smajlaj, zyrtare për bashkëpunim, ZKA, Reshat Nurboja, kabineti i Kryetarit të Kuvendit, Festim Bytyçi, asistent Grupi AAK, Valmira Saraçi, gazetare RTK.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Elfete Alshiqi-Beqiri, Sabrije Saliuki, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

**Mbledhjen e kryesoi:** Armend Muja, kryetar i Komisionit.

## **Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.04.2022;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr.08/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim për Projektligjin nr.08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Projektligjin nr.08/L-136 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;**
- 6. Shqyrtimi i Listës së kandidatëve për plotësimin e një (1) pozite për anëtarë jo-ekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës;**
- 7. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2021;**
- 8. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.08/L-134 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-115, me Ligjin nr.04/L-168 dhe Ligjin nr.05/L-116;**

## **9. Të ndryshme.**

**Mërgim Lushtaku**, propozoi që pika e 8-të të kalojë si e 3-ta për diskutim dhe të bëhet ri-renditja e pikave të tjera.

Pas propozimit dhe diskutimit për ri-renditjen e pikave, kryetari hodhi në votim rendin e ditës me ndryshimet e propozuara.

Me 3 vota për, 5 vota kundër, kryetari, konstaton se propozimi i deputetit z. Lushtaku nuk e mori mbështetjen e Komisionit.

## **1.Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur të Komisionit më 13.04.2022**

Me shumicë votash, Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur të Komisionit më 13.04.2022.

## **3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr.08/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit**

Kryetari, në bazë të nenit 57, paragrafi 9, të Rregullores së Kuvendit, pasi që raporti me amendamente shqyrtohet nga komisionet e përhershme, konsiderohet se komisioni e ka përfunduar shqyrtimin e projektligjit dhe e procedon për lexim të dytë. Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akcizën në Produktet e Duhanit dhe ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm dhe rekomandon që projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet në Kuvend për shqyrtim. Komisioni për Integritet Evropian e ka shqyrtuar projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akcizën në Produktet e Duhanit dhe ka vlerësuar se projektligji me amendamentet e propozuara nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nuk ka paraqitur Raport me Rekomandime për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akcizën në Produktet e Duhanit, brenda afatit ligjor.

Pasi nuk pati diskutime, Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

### **Përfundim**

1. Miratohet Raporti me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit.
2. Raporti me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit, procedohet për lexim të dytë në Kuvend sipas procedurës.

### **4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim për Projektligjin nr.08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja**

**Kryetari**, Projektligji nr.08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, është shqyrtuar nga Komisioni Funkcional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, i cili komisioni ka dërguar raportin me amendamente. Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në cilësinë e komisionit të përhershëm, deklarohej për koston shtesë të Projektligjit dhe amendamenteve, dhe raportin me rekomandime e procedon te Komisioni Funkcional. Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, vlerëson se Projektligji nuk do të krijojë kosto shtesë buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës

Pasi nuk pati diskutime, Komisioni me shumicë votash nxori rekomandimin për Komisionin Funkcional si në vijim:

### **R e k o m a n d i m**

1. Projektligji nr.08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim për Projektligjin nr.08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

### **5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Projektligjin nr.08/L-136 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës**

**Kryetari**, Projektligji nr.08/L-136 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, është shqyrtuar nga Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, i cili komisioni ka dërguar raportin me amendamente. Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në cilësinë e Komisionit të Përhershëm, deklarohet për koston shtesë të Projektligjit dhe amendamenteve, dhe raportin me rekomandime e procedon te Komisioni Funkcional. Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, në bazë të Deklaratës së Ndikimit Buxhetor dhe Financiar, vlerëson se zbatimi i Projektligjit nuk krijon kosto shtesë buxhetore.

Pasi nuk pati diskutime, Komisioni me shumicë votash nxori rekomandimin për Komisionin Funkcional si vijon:

#### **R e k o m a n d i m**

1. Projektligji nr.08/L-136 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Projektligjin nr.08/L-136 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

### **6. Shqyrtimi i Listës së kandidatëve për plotësimin e një (1) pozite për anëtarë jo-ekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës**

**Kryetari:** Në bazë të nenit 38 dhe nenit 40 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Bordi i Bankës Qendrore me vendim nr.5/2022, datë 27 janar 2022, ka emëruar Panelin për përzgjedhjen e kandidatëve për plotësimin e një(1) pozite për anëtarë jo-ekzekutiv të Bordit

të BQK-së me këtë përbërje: Flamur Mrasori – kryetar i panelit, Fehmi Mehmeti – anëtar i panelit, Nora Latifi-Jashari anëtare e panelit dhe Bashkim Nurboja anëtar i panelit. Paneli ka njoftuar se ka zhvilluar procedurat e konkursit dhe pas vlerësimit të kualifikimeve dhe performancës së aplikantëve të ftuar për intervistë, ka bërë përzgjedhjen e kandidatëve që i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret formale që kërkohen me Ligjin e BQK-së. Bazuar në nenin 40 paragrafi 1, të Ligjit për BQK-në, Personat që kualifikohen për t'u zgjedhur që të shërbejnë në organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore duhet të jenë me integritet dhe të kenë diplomë universitare si dhe të kenë të paktën dhjetë (10) vjet përvojë profesionale apo akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitetit apo çështjeve juridike. Si rrjedhojë, Paneli për Përzgjedhje, i ka dërguar Kuvendit listën me emrat e pesë kandidatëve të përzgjedhur, për plotësimin e një pozite të anëtarit jo-ekzekutiv të Bordit të BQK-së, dhe ata janë: 1. Arta Hoxha, 2. Esida Bujupi, 3. Lulzim Ismajli, 4. Nexhat Kryeziu dhe 5. Nora Rraci. Njëkohësisht, në bazë të nenit 38.2 Ligjit për BQK, Paneli për Përzgjedhje, i ka dërguar listën me emrat e propozuar në Qeveri, e cila mund t'i dërgoi Kuvendit mendimin e saj lidhur me kandidatët e propozuara, brenda afatit prej 15 ditësh. Qeveria, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, i ka dërguar Kuvendit mendimin dhe pajtohet me kandidaturat e propozuara nga Paneli Seleksionues për përzgjedhjen e një anëtari jo-ekzekutiv në Bordin e BQK-së.

**Mërgim Lushtaku**, pyet kryetarin se a është i informuar që deputetët kanë pranuar një ankesë sa i përket përzgjedhjes së anëtarit jo-ekzekutiv të Bordit ?

**Kryetari:** Jam i informuar për ankesën e një kandidati, por nuk jam i sigurt që ankesa i drejtohet këtij Komisioni, apo Kuvendit të Kosovës dhe ligji nuk e ka paraparë Komisionin si shkallë të dytë të ankesave. Ligji e parasheh që Kuvendi me mendimin e vet mund të konstatojë nëse dikujt u është shkelur ndonjë e drejtë, por i njëj mundësinë edhe secilit kandidat që mendon që gjatë procesit të selektimit për punësim i është shkelur ndonjë e drejtë të shkojë përmes gjykatave të rregullta.

**Avdullah Hoti**, lidhur me listën, e pashë shkresën e BQK-së dhe nenet përkatëse të Ligjit për BQK-në. Neni 38 kërkon që paneli të përzgjedh aplikantët në bazë të kualifikimeve dhe performancës gjatë intervistimeve, dhe të jap sqarim me shkrim mbi bazën që e ka propozuar këtë listë. Ky sqarim mungon dhe paneli vetëm i ka cituar nenet e ligjit për BQK-në, dhe kanë thënë se këta janë kandidatët që i kanë plotësuar kushtet, por nuk ka dhënë arsytim për secilin kandidat se pse i plotësojnë kushtet dhe cila ka qenë performanca e tyre gjatë intervistimit. Na duhet një vlerësim kualitativ për secilin prej kandidatëve, ngase plotësimi i kushteve formale juridike sipas ligjit është proces teknik. E dyta, për ankesat që janë bërë në njërin prej tyre është person që ka CV-në më të pasur se secili prej kandidatëve tjerë që është në listën e përzgjedhur, por ky është vetëm vlerësim i imi. Kandidatja e parë nuk i plotëson as kushtet formale juridike sipas ligjit sa i përket përvojës 10-vjeçare në bazë të CV-së që është dorëzuar. Për më tepër është kryesuese e Komitetit të Auditimit në Zyrën e Kryeministrit edhe pse anëtare e jashtme dhe ligji

e bën të qartë në nenin 40, paragrafi 3 ku thotë se asnjë person nuk do të shërbej në organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore nëse është anëtar i Kuvendit, Qeverisë, zyrtar i ndonjë ministrie ose zyrtar në institucione financiare etj. Angazhimi i saj në Komitet të Auditimit në Zyrën e Kryeministrit bije ndesh me nenin 40. Unë mendoj që Paneli Intervistues nuk e ka kryer punën që është dashur në tërësi ta kryej dhe nuk pajtohem që ne, si Komision t'ia dërgojmë Kuvendit. Duhet të kërkohet sqarim për secilin prej këtyre propozimeve dhe pastaj mund ta vendosim në rend të ditës në mbledhjet e ardhshme dhe t'ia dërgojmë Kuvendit.

**Ferat Shala**, theksoi se do të ishte mirë që ta kemi si Komision një informacion nga Paneli Intervistues për kandidatin që është ankuar te deputetët dhe ta kemi arsyeshmërinë se pse është refuzuar kandidati dhe të shohim punën e panelit. Ky kandidat i plotëson të gjitha parametrat ligjore dhe profesionale, dhe ne nuk kemi asnjë arsye se pse nuk është i përfshirë në listë. Konsideroj të shtyhet kjo pikë derisa të marrim një vlerësim nga Paneli për secilin kandidatë të gjithë deputetët dhe ta shohim ligjshmërinë, e pastaj ta procedojmë tutje.

**Pal Lekaj**, potencoi se është e drejtë ajo çka u tha se duhet të bazohemi në ligj dhe të veprojmë sipas normave ligjore për të proceduar më tutje. Unë pajtohem që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet deri sa të kemi informacione nga Paneli Intervistues për secilin kandidat individualisht.

**Kryetari**, theksoi nga diskutimet që u bënë, janë dy pika që kërkojnë vëmendje. E para është referimi i deputetit z. Hoti në lidhje me kandidatin e parë dhe mundësia që potencialisht kandidati mund të bije ndesh me normat ligjore, kurse si pikë e dytë se ekziston një ankesë nga një kandidat që pretendon se gjatë intervistimit i janë shkelur të drejtat e një konkursi të barabartë. Gjithashtu, ishin edhe disa mendime për disa kandidatë që potencialisht kanë mundur të jenë pjesë e listës. Ligji kufizon Komisionin dhe mandatin e vendimmarrjes i është lënë Kuvendit dhe sugjeroj që kërkesat për informacionet, së bashku me ankesën dhe vërejtjen për kandidatin e parë t'i bartet seancës që ata pastaj ta sqarojnë.

**Pal Lekaj**, tregoi se ka pasur edhe praktika të mëhershme kur është shtyrë votimi për ndonjë çështje për shkak të mungesës së informacionit dhe nuk duhet të injorohet kërkesa e Komisionit për t'u shtyrë kjo pikë.

**Avdullah Hoti**: Ne mund të kemi dallime në opinione sa i përket vlerësimit të kandidatëve, por kur dilema është për ligjshmërinë e një procesi është detyrë e secilit anëtar dhe juve si kryetar që të sigurohet që nuk ka dilema të tilla. Ky propozim nuk duhet të shkojë në Kuvend pa marrë sqarimet nga Paneli Intervistues për secilin kandidat, e në veçanti për kandidatin e parë që sipas mendimit tim është në kundërshtim me pikën 3 të nenit 38 të ligjit.

**Enver Haliti**, tregoi që në këtë proces kanë marrë pjesë 35 kandidatë dhe prej tyre Paneli Përzgjedhës ka propozuar një listë të Qeveria, e cila pastaj e ka përcjellë tek ne. Në një rast tjetër

hipotetik, në qoftë se do të vinte ndonjë kërkesë nga ana e opozitës dhe të bëheshin këto kërkesa që tani po bëjnë subjektet opozitare do të ishte konsideruar si ndërhyrje te Paneli Përzgjedhës në Bankën Qendrore, për shkak se ne, si Komision nuk jemi të thirrur të shqyrtojmë dhe vlerësojmë ankesat e palëve. Vërejtjet e tilla është dashur të drejtohen te Paneli Përzgjedhës në afatin ligjor të ankimimit. Unë propozoj që ne, si Komision, ta procedojmë tutje për në seancë të Kuvendit.

**Ferat Shala**, sqaroi se kur bëhet fjalë për ligjshmërinë kemi praktika në të kaluarën ku kemi kthyer te Qeveria një listë të re të propozuar për një bord të caktuar dhe e ka pranuar si të ligjshme rekomandimin tonë. Kur ne, si deputet, kemi bazë të mjaftueshme për dyshim në shkelje të ligjit nuk do të ishte dashur as të diskutohet votimi si i tillë. Ne duhet të presim për informacion të ligjshmërisë dhe arsyeshmërisë.

**Kryetari**, potencoi se është e qartë për kandidatin që ka deponuar ankesë se nuk duhet t'i bëhet këtij Komisioni, por duhet të shfrytëzohet e drejta ligjore përmes gjykatave të rregullta. Në lidhje me informacionet shtesë sa i përket arsyeshmërisë për përzgjedhjen e secilit kandidatë është kërkesë valide.

**Kryetari**, konstatoi se nga ky diskutim janë nxjerrë këto konkludime: 1) kërkesa për arsyeshmërinë e përzgjedhjes për secilin kandidatë dhe 2) informacione shtesë për kandidatin e parë sa i përket plotësimin të kushteve ligjore. Ne do të kërkojmë nga BQK-ja që deri në mbledhjen tjetër të na ofrohen këto informacion dhe ta hedhim pastaj në votim.

## **7. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2021**

**Kryetari**, në bazë të nenit 66 të Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia për Informim dhe Privatësi, duhet t'i paraqes Kuvendit të Kosovës raport vjetor, jo më vonë se 31 mars të vitit vijues. Agjencia për Informim dhe Privatësi, ka dërguar raportin vjetor në Kuvend dhe Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere është ngarkuar që të shqyrtojë Raportin financiar të AIP-së, dhe të paraqes raportin me rekomandime në Kuvend. Lidhur me këtë pikë kemi ftuar përfaqësuesit e të AIP, nga të cilët kërkojmë që të prezantojnë dhe arsyetojnë Raportin në fjalë.

**Valon Kryeziu**, potencoi se Agjencia për Informim dhe Privatësi është agjenci e pavarur dhe përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Mbrojtje të Dhënave dhe Ligjit për Qasje në Dokumente Publike në shkallë të dytë në procedurë administrative.

**Mërgim Lushtaku**, duke u bazuar në praktikën e krijuar për raportim nga krerët e institucioneve do të duhej që para nesh të prezantojë komisionerja në fjalë e jo zëvendësuesit e saj.

**Kryetari**, theksoi se nuk pajtohet për shkak se janë afatet e caktuara se kur duhet të përfaqësohen institucionet dhe ftesa u është bërë herën e parë e tash në herën e dytë. Unë besoj se duhet ta dëgjojmë për shkak se edhe zyrtari kryesor financiar mund të raportojë, por po qe nevoja mund të kërkojmë sqarime shtesë nga komisionerja në mbledhjen tjetër.

**Valon Kryeziu**, vazhdoi raportimin duke treguar që prej muajit korrik ka filluar përmbushja e mandatit përmes kontrolleve dhe inspektimeve me një angazhim shtesë duke marrë parasysh edhe hartimin e akteve të reja nënligjore në zbatim të këtij ligji. Buxheti i përgjithshëm vjetor i agjencisë ka qenë 368,869 euro. Për paga dhe shtesa ka qenë 206,000 euro, kryesisht shpenzimet janë bërë 157,000 euro, në mallra dhe shërbime kanë qenë 135,000 euro e që janë shpenzuar 41,000 euro dhe shpenzime komunale kanë qenë 6,450 euro e që janë shpenzuar 1,238 euro. Të gjitha këto shpenzime kanë qenë në kuadër të parametrave dhe procedurave ligjore, duke zbatuar legjislacionin për sa i përket shpenzimeve buxhetore. Në raport me përqindje, nuk kanë qenë shpenzime në masë të mëdha, sepse kemi shpenzuar vetëm aty ku kemi pasur arsye për ta bërë dhe në këtë vit kemi një plan më të zgjeruar të performancës, ku kemi bërë kërkesë te Kuvendi për shtim të buxhetit. Ky Komision dhe Kuvendi me anë të Ligjit për Ndarje Buxhetore e ka bërë shtimin e kërkuar të buxhetit, ku na janë hapur rrugët për të rekrutuar staf të ri dhe ne japim garanci se ky buxhet do të administrohet sipas rregullave dhe parametrave të parapara ligjore.

**Eman Rrahmani**, pyet në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, a ka ndonjë të gjetur nga ana e auditorit për shkak se ju keni pranuar draftin nga Zyra Kombëtare e Auditimit?

**Valon Kryeziu**, tregoi se kanë pranuar draft-raportin nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe se në vitin e kaluar ka qenë vetëm një rekomandim te sistemi e-pasuria që është kompetencë dhe që e zhvillon Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Ky ka qenë i vetmi rekomandim dhe ne kemi bërë rreth 5 kërkesa në ASHI për ta instaluar këtë sistem, por sipas përgjigjes që kemi marrë është proces që e zhvillojnë ata. Edhe këtë vit e kemi rekomandimin e njëjtë, por që nuk është në kompetencën e agjencisë tonë për ta vendosur këtë sistem.

**Visar Korenica**, potencoi çështjen e vendosjes së kamerave nëpër komuna të ndryshme, ku keni dhënë vërejtje kryetarëve të komunave për t'i tërhequr ato. Njëra prej tyre ka qenë rasti në Komunën e Gjakovës dhe dëshiroj të pyes se a pasur ndonjë iniciativë tjetër që keni ndërmarrë në këtë aspekt që ju të kontrolloni apo vetëm në bazë të paralajmërimeve që ju vijnë në institucion?

**Valon Kryeziu**, në kuadër të mandatit Agjencia mbikëqyr edhe përpunimin e të dhënave personale përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë në sektorë të caktuar, por ne kemi parë që disa nga komunat këtë sistem e kanë zbatuar organet komunale. Ne kemi kërkuar dhe kemi lëshuar vendime në bazë të nenit 25 të Ligjit për Policinë, vendosjen apo mbikëqyrjen e



hapësirave publike e ka mandat vetëm policia si organ ligj zbatues. Kështu kemi vepruar në disa komuna si ajo e Pejës, Prishtinës, Graçanicës e të tjera.

**Bekim Haxhiu**, theksoi çështjen se kur ka kërkuar qasjen në dokumente publike në Ministrinë e Shëndetësisë për shkak të një kontrate të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë me UNOPS-in dhe që UNOPS-i ka zhvilluar procedurat e prokurimit dhe menaxhimit të kontratave. Ministria e Shëndetësisë i është përgjigjur kërkesës sime me arsyetimin se nuk mund të shihen kontratat milionëshe që ka zhvilluar UNOPS-i, ngase nuk i përgjigjet ligjeve të Kosovës, por atyre të OKB-së. Në këtë çështje nuk kam marrë asnjë reagim nga Agjencia dhe dëshiroj të pyes se a mundemi përmes jush që të obligojmë Ministrinë e Shëndetësisë apo UNOPS-in që të na lejohej të kemi qasje në këto dokumente?

**Valon Kryeziu**, përgjigjet se do ta trajtoj si çështje me Departamentin e Qasjes në Dokumente Publike dhe duhet ta ndajmë nëse procedurat janë zhvilluar nga UNOPS-i dhe buxheti është ndarë prej tyre, kurse nëse ka shpenzim që është bërë nga buxheti i institucioneve të Kosovës duhet të shohim aspektet e klasifikuara të ligjit në kontratë. Në qoftë se nuk ka ndonjë aspekt të klasifikuar ligjor, çdo shpenzim nga buxheti publik duhet të jetë i qasshëm për palët.

**Bekim Haxhiu**, tregoi se mjetet janë nga buxheti i Kosovës, ndërsa procedurat i ka zhvilluar UNOPS-i.

**Valon Kryeziu**, nëse është shpenzuar buxhet publik brenda asaj procedure, atë shumë është obligim ligjor që Ministria e Shëndetësisë ta ofrojë për palën e në këtë rast për ju.

**Kryetari**, sqaroi se sipas rregullit presim raportet e auditimit përpara se t'i hedhim në votim, mirëpo prezantimi bëhet në parim dhe në momentin kur ta kemi raportin e auditimit së bashku me prezencën e komisionerës do ta hedhim në votim.

**Avdullah Hoti**, sugjeroi që të mos mbyllet kjo temë, por kur të publikohet Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për këtë Agjenci të ftohet drejtori dhe të diskutohet sërish ngase kam disa çështje që do t'i diskutoja me kryeshefin e Agjencisë. Rasti që ngriti deputeti z. Haxhiu është shumë shqetësues dhe nuk është rasti i vetëm kur deputetët nuk kanë qasje në dokumentet zyrtare. Deputeti duhet t'i sigurohet qasje të plotë në të gjithë dokumentacionin publik, përveç atij që klasifikohet nga AKI-ja.

**Kryetari**, pas diskutimeve mund të nxjerrim disa konkludime: duhet të presim Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe kërkesa për informacion që nëse i keni duhet t' i depononi me shkrim dhe mundësisht pyetjet dhe sqarimet me shkrim t'i kemi të gatshme për diskutim në mbledhjet e radhës.

**Enver Haliti**, raportimi i kësaj Agjencie ka qenë ne rend dite më herët, por për shkak të zgjatjes së mbledhjes së Komisionit, komisionerja nuk ka mundur ta prezantojë raportin e Agjencisë.

**Mërgim Lushtaku**, nuk e mohoj që komisionerja ka qenë në mbledhjen e kaluar, por çdoherë që Komisioni Funkcional përkatës kërkon nga të zgjedhurit e Kuvendit të raportojë, është obligim pjesëmarrja dhe raportimi. Në këtë rast, kam pasur mbi 4-5 pika për sqarime dhe në mungesë të prezencës së komisioneres nuk i ngrita si çështje. Konsideroj se ka qenë e paarsyeshme mos prezenca e saj për raportim dhe nuk ka asnjë agjendë më të rëndësishme sesa të raportojë para Kuvendit.

**Pal Lekaj**, konsideroj se Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere është komisioni më serioz në trajtimin e çështjeve dhe raportimeve, andaj nuk duhet të injorohemi nga udhëheqësit e institucioneve.

**Kryetari**, sqaroi se komisionerja ka qenë e gatshme për raportim në herën e kaluar dhe ka pritur disa orë përderisa neve na është dashur ta mbyllim mbledhjen. Javët pasuese kemi pasur një udhëtim zyrtar dhe festat zyrtare e pastaj ka pasur çështje tjera që është dashur të hyjnë në rend të ditës për diskutim. Duhet të tregohemi korrekt ndaj komisionerës, pasi ajo na ka informuar për agjendën e saj dhe ne nuk mund të bllokojmë procesin për shkak të kohës së kufizuar që kemi dispozicion.

## **8. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.08/L-134 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligji nr.04/L-115, me Ligjin nr.04/L-168 dhe Ligjin nr.05/L-116**

**Kryetari**, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhje plenare, Komisioni Funkcional shqyrton projektligjin në parim dhe Kuvendit ia paraqet raportin me rekomandime. Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në cilësinë e Komisionit Funkcional është ngarkuar që të shqyrtojë Projektligjin nr.08/L-134 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-115, me Ligjin nr.04/L-168 dhe Ligjin nr.05/L-116 dhe Kuvendit t'ia paraqes raportin me rekomandime. Ky Projektligj është hartuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës. Ftoj deputetin Bekim Haxhiu që në emër të grupit prezantojë projektligjin.

**Bekim Haxhiu**, në cilësinë e propozuesit të këtij projektligji filloi prezantimin: Në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 53 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës ne kemi propozuar Projektligjin nr.08/L-134 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligji nr.04/L-115, me Ligjin nr.04/L-168 dhe Ligjin nr.05/L-116. Ky Projektligj plotëson kushtet formalo-juridike

sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës dhe është dërguar për mendim në Qeveri dhe i është shpërndarë deputetëve me datë 27 prill dhe tani është në shqyrtim në Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere. Qytetarët e Kosovës që nga fillimi i vitit 2020 janë duke u përballuar me krizën nga pandemia, pastaj nga kriza energjetike e së fundi nga kriza ekonomike dhe inflacioni, andaj kemi iniciuar ndryshimin e Ligjit për Trustin që qytetarëve t'ju mundësohet tërheqja e disa prej kursimeve të tyre pensionale nga 10-30%. Në vazhdim do të bëjë prezantimin e shkurtër të projektligjit:

#### Neni 1 – Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim që përmes plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit 04/1-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/1-115, me Ligjin 04/1-168 dhe Ligjin nr. 05/1-116, pjesëmarrësve të trustit t'ju krijohet bazë ligjore për tërheqjen e vlerës prej dhjetë (10) deri tridhjetë (30) për qind (%) të kursimeve të tyre pensionale në FKPK, në përputhje me nenin 12A të këtij ligji, si masë konkrete për mundësimin e përballimit më të lehtë të pasojave ekonomike të shkaktuara nga pandemia COVID-19 dhe inflacioni në ekonomi.

Në nenet 2 dhe 3 rregullohen fushëveprimi dhe përkufizimet.

Në nenin 4 janë ndryshimet e aspektit praktik për zbatimin e ligjit.

Në nenin 12 shtohet një nen i ri 12A me tekstin si në vijim:

#### Neni 12A - Pagesa e kursimeve individuale pensionale

Pjesëmarrësit mund t'i tërheqin dhjetë (10) deri tridhjetë (30) për qind (%) të kursimeve të tyre pensionale në FKPK, sipas përshkrimit në vijim: 1.1. Personat që kanë kursime pensionale në shumën më pak se 10.000 Euro, kanë të drejtë t'i tërheqin deri në tridhjetë për qind (30%) të kursimeve të tyre pensionale në FKPK; 1.2. Personat që kanë kursime pensionale në shumën prej 10.000 Euro deri në 19.999 euro, kanë të drejtë t'i tërheqin deri në njëzetepesë për qind (25%) të kursimeve të tyre pensionale në FKPK; 1.3. Personat që kanë kursime pensionale në shumën prej 20.000 euro deri në 29.999 Euro, kanë të drejtë t'i tërheqin deri në njëzetë për qind (20 %) të kursimeve të tyre pensionale në FKPK; 1.4. Personat që kanë kursime pensionale në shumën prej 30.000 euro deri në 39.999 euro, kanë të drejtë t'i tërheqin deri në pesëmbëdhjetë për qind (15%) të kursimeve të tyre pensionale në FKPK; 1.5. Personat që kanë kursime pensionale me shumë se 40.000 euro (dyzet mijë), kanë të drejtë t'i tërheqin deri në dhjetë për qind (10%) të kursimeve të tyre pensionale në FKPK.

2. Me qëllim të tërheqjes së mjeteve sipas paragrafëve 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 të këtij neni, pjesëmarrësit aplikojnë në formë elektronike pranë FKPK-së brenda gjashtë (6) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Çdo aplikacion që merr FKPK në formë elektronike e trajton atë si të mirëqenë dhe zyrtare, dhe shqyrton kërkesën sipas dispozitave të këtij neni. Procedura e aplikimit zhvillohet sipas procedurave të përcaktuara sipas legjisllacionit në fuqi për procedurën e përgjithshme administrative.

3. Aplikacioni sipas paragrafit 2 të këtij neni është i kushtëzuar me pëlqimin e aplikantit për përpunimin e të dhënave të tij, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Me kërkesë të FKPK-së, BQK-ja, Agjencia e Regjistrimit Civil, Administrata Tatimore e Kosovës, Thesari i Kosovës dhe institucionet tjera relevante, si dhe bankat komerciale të licencuara nga BQK ndajnë të dhënat e nevojshme të pjesëmarrësve, me qëllim të shqyrtimit të kërkesave.

5. Mjetet nga kërkesat e aprovuara nga FKPK transferohen në llogaritë bankare të përfituesve në bankat komerciale të licencuara nga BQK-ja dhe tërheqja e mjeteve bëhet vetëm nëpërmjet llogarive bankare.

6. Pagesa e mjeteve të aprovuara bëhet në bazë të numrit, çmimit dhe vlerës së njësisë që ka çdo aplikant në llogarinë e tij personale në FKPK në ditën e aplikimit, përfshirë këtu ndryshimet eventuale në çmimin e njësisë deri në datën e pagesës.

7. Mjetet e tërhequra sipas këtij neni, janë të përjashtuara nga tatimi në të ardhurat personale.

Neni 5 - Vlefshmëria e Ligjit.

1. Pas datës prej gjashtë muaj nga fillimi i zbatimit, të gjitha dispozitat e këtij ligji do të shfuqizohen në mënyrë automatike.

Me këtë propozim do të mbështetën qytetarët që kanë të ardhura më të ulëta dhe ata që kanë më pak mjete më pak në TRUST do të ju lejohet të tërheqin më shumë për të përballuar krizën ekonomike dhe rritjen e çmimeve enorme në të gjithë sektorët. Meqenëse, jam pjesë e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, konsideroj se pas miratimit të këtij Projektligji kemi nevojë të punojmë së bashku si dy komisione për reformën pensionale. Ky Projektligj do të ketë efekt pozitiv në jetën e qytetarëve dhe do të ketë impakt pozitiv në buxhetin e shtetit dhe ekonominë e vendit. Fondi i Kursimeve Pensionale ka deklaruar se është i gatshëm për zbatimin e këtij Projektligji në momentin kur Kuvendi e miraton. Sipas raporti të fundit të TRUST-it në tremujorin e parë të vitit 2022 shihet se 1 miliardë 732 milion euro janë të investuara jashtë vendit, ndërsa 600,228,000 milionë euro janë mjete të TRUST-it në Kosovë dhe ekzistojnë mjete të mjaftueshme të TRUST-it për t'ia realizuar këtë kërkesë. Projektligji në fjalë nuk përmban implikime shtesë për buxhetin e Kosovës, përkundrazi do të ketë impakt pozitiv në të. Ju ftoj që ta mbështesni këtë Projektligj për interesin e qytetarit.

**Kryetari**, theksoi dy çështje dhe si çështje e parë është Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave po ashtu e ka dërguar një deklaratë rreth ndikimit buxhetor që e keni në kuadër të materialeve dhe ata deklarojnë kështu: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Buxhetit vlerëson se Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-115, me Ligjin nr.04/L-168 dhe Ligjin nr.05-116, nga aspekti i ndikimit buxhetor nuk krijon kosto shtesë

buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, mirëpo do të ketë ndikim negativ në pjesën e të hyrave nga tatimi në te ardhura personale në shumë prej 13,530,000 euro si të hyra të munguara tatimore nga pjesa e tërhequr e kursimeve pensionale. Gjithashtu, në kuadër të materialeve keni edhe mendimin e Qeverisë ku është deklaruar në këtë mënyrë: Qeveria e Republikës së Kosovës nuk pajtohet me propozimin e deputetit z. Haxhiu dhe Qeveria e Republikës së Kosovës është afër qytetarëve, për të ndihmuar përmes rishpërndarjes, rritjes së punësimit, rritjes së mbështetjes në skemat sociale, fëmijëve, grave dhe të rinjve, si dhe fermerëve e ndërmarrësisë së vogël e të mesme. Tërheqja nga Trusti nuk ndihmon kategoritë në nevojë, pasi vetë përqindja e fondit pensional të tyre është e ulët. Me kursimin e pleqërisë nuk duhet abuzuar dhe veprimin e atillë, duhet konsideruar si të mangët. Nisur nga kjo që u tha më lart, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk përkrah iniciativën e deputetëve nënshkrues të nismës legjislative, të përshkruar në kuadër të këtij vendimi.

**Avdullah Hoti**, tregoi vlerësimet e veta dhe Grupit Parlamentar të LDK-së për këtë projektligj. Kjo është një masë drastike dhe këto masa janë për kohë që nuk janë të zakonshme, kështu ishte edhe në rastin e pandemisë kur ne atëherë në Qeverinë e kaluar vendosëm të ndryshojmë Ligjin për Trustin Pensional dhe të lejohet një tërheqje e caktuar e kursimeve pensionale. Vlerësimi ka qenë se ky veprim i Qeverisë së atëhershme dhe mbështetja e Kuvendit ka mundësuar që përmes atij veprimi të futen në ekonomi, afër 200 milionë euro bashkë me remitancat që kanë qenë rekord për vitin 2021 e së bashku me pakot e ndryshme të mbështetjes drejtpërdrejt nga buxheti për familjet dhe bizneset. Efekti i tyre ka qenë që në janar të vitit 2021 u kalua ajo krizë. Kur është propozuar kjo çështje nga deputeti z. Haxhiu para 3-4 muajve, unë nuk kam qenë ndër mbështetësit e menjëhershëm sepse dihej që po hynim në një krizë energjetike, e mandej edhe lufta në Ukrainë krijoi probleme në furnizim dhe rritje masive të shportës së mallrave të konsumit. Unë kam pritur që përmes veprimeve të caktuara të Qeverisë nuk do të ketë nevojë që të marrim masa të tilla jo të zakonshme, por me kalimin e kohës masat që u ndërmorën ishin shumë parciale me ndikim minimal. Në diskutimet që janë bërë në Kuvend, me disa propozim-rezoluta kryesisht nga opozita patëm propozuar një listë veprimesh që duhet ndërmarrë për të tejkaluar krizën për të mos ardhur në këtë pikë. Disa nga këto propozime ishin indeksimi i të gjitha përfitimeve pensionale dhe sociale me normën e inflacionit, norma mesatare e inflacionit është 11% brenda vitit, por norma e inflacionit brenda shportës së konsumit të mallrave që blejnë familjet sipas Agjencisë së Statistikave është së paku 50%. Kjo nënkupton që familjet që kanë të ardhura në shumë prej 300-400 euro u janë zvogëluar të ardhurat për 30-40%. Veprimet e tjera të propozuara kanë qenë edhe subvencionimi i bujqve, por që ende mjetet nuk kanë shkuar te bujqit dhe efektet do të shihen në vjeshtë të të korrat, sepse ka plotë hapësira të tokës bujqësore që nuk është punuar mjaftueshëm si është punuar viteve të kaluara për shkak të kostos së inputeve bujqësore është rritur me 20%-30% deri në 50% në krahasim me vitin të kaluar. Debati për pagën minimale nuk është finalizuar dhe ka shkuar në drejtim të gabuar duke shpërndarë lidhjen e pagës minimale me skemat e ndryshme sociale dhe pensionale që kanë pasur për qëllim ruajtjen e standardit të personave që varen nga këto skema. Po ashtu, ka pasur propozim nga ana jonë edhe për çmimet e naftës, por që nuk është ndërmarrë asnjë veprim në atë drejtim. Në qoftë se do

të fiksohej ngarkesa tatimore në litër të naftës, ne do të zbrisnim çmimin për 12-13 cent për litër dhe prape do të mblidhnim njësoj TVSH nga nafta e importuar. Ne e mbështesim tërësisht këtë projektligj dhe në opinionin e marrë Qeveria, nuk ka dhënë sqarimet e nevojshme se pse përmes veprimeve të tjera të Qeverisë arrihet efekti i njëjtë. Problem tjetër është edhe vlerësimi i opinionit buxhetor të cilin kryetari i Komisionit e sqaroi edhe njëherë para nesh. Ministria e Financave – Departamenti i Buxhetit thotë se ky projektligj do të ndikoj negativisht në të hyrat nga tatimi në 13.5 milionë euro që është një anomali, ngase këto nuk kanë qenë të planifikuara asnjëherë në të hyrat për vitin 2022 apo 2023, apo edhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Kjo nuk qëndron dhe nuk do të ndikohen fare të hyrat buxhetore nga mundësia që u jepet qytetarëve për të tërhequr këto mjete. Prandaj, jam shumë i pakënaqur me këtë opinion buxhetor që është joprofesional dhe joadekuat, edhe me opinionin e Qeverisë dhe në mungesë të veprimeve të Qeverisë për të kompensuar qytetarët në këtë krizë me të cilën po përballemi, nuk ka zgjidhje tjetër përveç të mbështesim një iniciativë të tillë.

**Pal Lekaj**, theksoi se nuk pajtohet me opinionin e Qeverisë, ngase apriori të deklarohet Qeveria e Republikës së Kosovës që nuk e mbështet përderisa është kompetencë ekskluzive e Kuvendit, mendoj se është e pavend dhe e ngutshme. Qeveria është dashur të jap këshilla apo sugjerime, por jo të ndikoj mbi Kuvendin e Kosovës. Ju bëj thirrje që të leni anën politike dhe të fokusohemi bashkërisht në të mirën e përbashkët e që është qytetari. Mund të mos jetë metoda më e mirë e mundshme që t’ju qasemi qytetarëve, por përderisa ekziston kjo krizë Qeveria është e thirrur për t’i zgjidhur problemet e qytetarëve. Vota ime dhe e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do të jetë pro.

**Duda Balje**, tregoi se në emrin e Grupit Multietnik do të abstenoj për shkak të respektimit të mendimit të grupit të tyre.

**Kryetari**, potencoi arsyet e kundërshtimit të këtij propozimi dhe nuk ka të bëjë asgjë me inate personale. Në vitin 2020 është miratuar Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike për tërheqjen e rreth 200 milionë eurove nga kursimet pensionale. Sipas TRUST-it pensional në periudhën ndërmjet dhjetorit 2020 deri në prill 2021 janë tërhequr mbi 200 milionë euro dhe kushti i PDK-së ishte që do të votonte, por me kushtin që ato të rimbursohen. Në kuadër të kësaj, është integruar edhe një nen që rreth 105-120 milionë euro që duhet të rimbursohen dhe si obligim i mbetet Qeverisë. Sa i përket praktikës, TRUST-i pensional dhe kursimi është obligim duke krahasuar edhe me të gjitha vendet e botës ku skemat pensionale janë obligim dhe nuk kam gjetur në ndonjë vend të botës që pa marrë parasysh shkallën e inflacionit apo krizës ekonomike t’ju drejtohet kursimeve pensionale për të zgjidhur problemin. Shumica e qeverive kanë propozuar masa fiskale ose masa monetare, por jo duke i prekur kursimet pensionale të qytetarëve. Në vitin 2020 është e vërtetë që kishte një tkurrje ekonomike prej 5% dhe arsyetimi ishte që konsumi kishte ngecur e që tërheqja e mjeteve do të rigjallëronin kërkesën agregate. Dallimi me situatën e tanishme është se konsumi në këtë vit është 22% më i madh sesa konsumi i vitit të kaluar dhe nëse matet me vitin 2020 do të jetë shumë më i lartë. Struktura e shpenzimeve – kërkesa ime ndaj TRUST-it ishte se po të zbatohet një ligj i tillë cili do të ishte implikimi financiar dhe nuk pajtohem me mënyrën se si

është bërë vlerësimi i ndikimit buxhetor qoftë nga Kuvendi apo Ministria e Financave. Ajo që ne po e humbin është vlerësimi i tërësishëm buxhetor nga tërheqja dhe në bazë të TRUST-it propozimi nënkupton tërheqjen e 594 milionë euro nga të cilat në kategorinë e atyre që përfitojnë nga tërheqja 10% janë 15 milionë euro me 2700 përfitues; në kategorinë e atyre që përfitojnë 15% tërhiqen 18 milionë euro me 3600 përfitues; në kategorinë e atyre që përfitojnë 20% tërhiqen 45 milionë euro me 9000 përfitues; në kategorinë e atyre që përfitojnë 25% tërhiqen 169 milionë euro me 51000 përfitues dhe në kategorinë e atyre që përfitojnë 30% janë 628,000 përfitues dhe vlera e tërheqjes do të ishte 345 milionë euro. Pra, nëse shikohet te mesatarja e kategorive se kush tërheq nga TRUST-i i bie që kategoritë që kanë mjete më shumë në trust të tërheqin mesatarisht 5000 euro; kategoria që tërheqin 15% po ashtu do të tërhiqnin mesatarisht 5000 euro; kategoria që tërheqin 20% po ashtu do të tërheqin mesatarisht 4800 euro; kategoria që tërheqin 25% do të tërheqin mesatarisht 3300 euro, kurse kategoria e fundit i bie që të tërheq rreth 52 euro. Mbi bazën e raportit të TRUST-it nga 1.2 milion njerëz të aftë për punë rreth 530,000 mijë persona nuk kanë fare llogari në TRUST. Përfundimi im është se ky propozim është i dizajnuar që të ndihmojë shtresat e pasura të shoqërisë mbi bazën e këtyre fakteve: 60,000 persona tërheqin 300 milionë euro, kurse 628,000 persona të tjerë tërheqin pjesën tjetër të mbetur, prandaj ky propozim nuk arrin të ndihmojë shtresat e varfra. Gjithashtu, janë diku rreth 533,000 persona që nuk fitojnë fare dhe baza reale e atyre që ju mundësohet të përfitojnë nga ky ligj janë personat me të ardhura të mira financiare. Një kategori tjetër, e që nuk përfitojnë nga ky propozim janë vajzat dhe gratë për shkak të përjashtimit të tregut të punës dhe kanë një qarkullim tejet të ulët në krahasim me djemtë dhe burrat. Argumenti tjetër është se tërheqja e 600 milionë euro në këtë fazë, ku mosha mesatare e atyre që kanë kursime pensionale është 37 vjet dhe kjo tërheqje do të krijonte implikimin e kthimin e munguar të investimit që në baza 20 vjeçare prodhonte një efekt prej 2 miliardë eurove. Ky propozim nuk do të mbërrij synimin e ndihmesës së atyre familjeve që po kalojnë më së vështiri krizën nga inflacioni dhe Qeveria ka propozuar disa iniciativa që janë refuzuar, siç është paga minimale e cila nuk është rritur prej 10 vitesh, e që 120,000 persona parashihet të përfitojnë nga dyfishimi i pagës minimale. Ne, po ashtu, kemi arritur një marrëveshje ndërkombëtare që ndihmon shtresat që përfitojnë nga skemat pensionale dhe është refuzuar pikërisht nga propozuesit e këtij projektligji. Gjithashtu, dy ekspertë të FMN-së para dy javësh kanë qenë të shqetësuar për diskutimin e këtij propozimi dhe ekziston rrezikimi i gjithë raportit me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Konsideroj se ky propozim është abuzim me të kursimet pensionale të pleqërisë.

**Bekim Haxhiu**, theksoi se në vitin 2020 nuk janë tërhequr mbi 200 milionë euro, por janë tërhequr 197 milionë euro dhe prej përfitueseve potencial vetëm 53.4% kanë aplikuar për të tërhequr mjete nga TRUST-i. Sipas këtij raporti të publikuar nga TRUST-i për tërheqjen 10% vërehet që ka një tërheqje të mjeteve kryesisht të kategorive që kanë pasur nën 20,000 euro në TRUST. Sipas një raporti tjetër të publikuar nga TRUST-i rezulton se prej 639,000 kontribuueseve në TRUST, vetëm 2% e tyre janë që kanë kursime mbi 20,000 euro dhe shumica prej tyre janë prej që kanë prej 100-20,000 euro dhe kjo përbën prej 71% të kontribuueseve. Ideja është që përmes TRUST-it të mbështetën personat që janë në marrëdhënie pune dhe kanë

kursime në TRUST, kurse buxheti i Kosovës të orientohet në kategoritë e rrezikuara si të papunët, pensionistët, gratë, studentët e të tjera, ose të ndërmerren masa tjera fiskale. Në vitin 2018 Kuvendi i Kosovës ka miratuar një Komision ad-hoc për Reformën Pensionale, i cili ka deponuar një raport që është më se e nevojshme të bëhet reforma dhe të ndryshohet modeli aktual, dhe të kalohet në një model të ri ku gjenerata paguan për gjeneratën. Fondi i Kursimeve Pensionale në këtë moment është stabil dhe do të jetë edhe në të ardhmen, sepse mesatarja e moshës së kontribut dhënësve në TRUST është e re.

**Kryetari**, ky propozim duhet të studiohet dhe reformat e tilla marrin parasysh reformat paramterike, bazat e kontribuueseve dhe në Kosovë kemi 385,000 punëtorë, kurse janë mbi 200,000 përfitues të pensioneve. Në këtë fazë të shkohej me këtë reformë pa e studiuar nga gjenerata kontribuon te gjenerata do të ishte i vogël kontributi.

**Bekim Haxhiu**, në aspektin profesional Komisioni ad-hoc ka qenë i përbërë prej deputetëve dhe ekspertëve të jashtëm të cilët kanë propozuar një reformë të tillë.

**Ferat Shala**, ne jemi para një situatë që është pasojë e pandemisë, krizës energjetike dhe inflacionit dyshifror që ka kapluar vendin. Jo gjithë herë shifrat dhe numrat janë të bazuara në arsyen dhe nevojën qytetare, përfituesit më të mëdhenj do të ishin punëtorët e arsimit që janë në numër të madh. Nuk do të ishte dashur që t'ia mohojmë punëtorëve të sigurisë, policisë, shërbyesve civilë që nuk mund t'i tërheqin mjetet e tyre dhe çfarë ju ofruan institucionet e shtetit të gjitha kategorive të mesme dhe të ulëta që kanë pagën minimale. Përgjigja e Departamentit ishte për keqardhje pa bazë logjike, shkencore dhe financiare, dhe po ashtu nuk është vullneti ynë të dëmtojmë institucionin e TRUST-it. Ne jemi detyruar në rrethanat e krijuara nga situata dhe mos menaxhimi i mirë nga Qeveria, të kërkojmë që ta mbështetni dhe të kalojë sa më shpejt në Kuvend që të ndikojë në përmirësimin e situatës për kategoritë e ndryshme sociale.

**Mërgim Lushtaku**, potencoi disa argumente te disa çështje që ngriti Z. Muja në lidhje me iniciativën që Partia Demokratike ka bërë dhe prezantimin që bëri Z. Haxhiu për Projektligjin. Ne kemi diskutuar edhe në këtë Komision për mënyrat se si duhet të mbështesim qytetarët në situatën e krijuar nga kriza e pandemisë, luftës në Ukrainë, kriza ekonomike apo edhe vjedhjet që janë bërë të energjisë elektrike dhe, po ashtu, kemi kërkuar si opozitë për të diskutuar edhe me përfaqësuesit e TRUST-it bashkërisht dhe ekspertë të fushave të tyre, gjë që nuk është realizuar. Ne po detyrohemi të kemi një iniciativë të tillë përderisa e shohim neglizhencën e Qeverisë për ndërmarrjen e veprimeve konkrete për t'ju ndihmuar qytetarëve dhe bizneseve të caktuara. U përmend Ligji për Pagën Minimale dhe nëse kishim pasur një dialog, sigurisht se ne do të mbështesim propozimin për rritjen e pagës minimale. Fatkeqësisht, Qeveria me arrogancë është shmangur nga diskutimi për ndryshimin e bazës ligjore për rritjen e pagës minimale dhe nuk është e drejtë t'i shmangeni vetëm se nuk po gjeni gjuhë të përbashkët me aktorët kryesorë të dialogut social. Përbaljet me FMN-në kanë qenë të shumta duke filluar që nga rasti me rritjen e pagave nga Qeveria Thaçi dhe me ekspertët e fushave kemi arritur të tejkalojmë edhe shqetësimet e FMN-së duke arritur në realizimin e qëllimit. Kjo iniciativë do të ketë ndikim



direkt dhe indirekt në ekonominë e vendit, pasi besoj se këto mjete do të shfrytëzohen për qëllime si mbijetesa apo shlyerja e borxheve të ndryshme dhe kërkoj nga kolegët që të votohet ky Projektligj për t'ju dal në ndihmë qytetarëve të vendit.

Pas përfundimit të të gjitha diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni me 5 vota për, 5 vota kundër dhe 1 votë abstenim nxori rekomandimin për Kuvendin e Kosovës, si në vijim:

### **R e k o m a n d i m**

Komisioni i rekomandon Kuvendit të mos miratoi në parim Projektligjin nr.08/L-134 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-115, me Ligjin nr. 04/L-168 dhe Ligjin nr.05/L-116.

### **9.Të ndryshme**

**Kryetrari:** pyeti nëse ka ndonjë çështje për tu ngritur në pikën në të ndryshme. Meqë nuk ka, e mbylli mbledhjen.

**Mbledhja përfundoi në orën 12:00.**

**E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit**

**Armend Muja,**

-----

**Kryetar i Komisionit**